



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 1.7 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 4, 5 dhe 13 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2013 për Caqet e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë,
- Aplikacionin/Kërkesën për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga era, "Wind Park-Bajgora" Zona Kadastrale Selac, me kapacitet prej 56.1 MW, KK Mitrovicë, të datës 24.07.2014 të shoqërisë "ENERGY FIRST - ONE" SH.P.K., me adresë rr. "Garibaldi", nr. 04/14 – Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës, dhe
- Kërkesën për rishqyrtimin e aplikacionit/kërkesës për autorizim për "Wind Park – Bajgora", në kapacitetin e lejueshëm të caqeve (nga 56.10MW në 34.25 MW), të datës 12.11.2014 shoqërisë "ENERGY FIRST - ONE" SH.P.K., me adresë rr. "Garibaldi", nr. 04/14 – Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 21 nëntor 2014 nxori këtë:

V E N D I M

Mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar

- I. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) konstaton se shoqëria "ENERGY FISRT - ONE" SH.P.K., ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit "Wind Park-Bajgora" për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues, për prodhimin e energjisë elektrike nga era, me kapacitet të instaluar prej 34.25 MW, në lokacionin Selac, KK Mitrovica.
- II. Aplikuesit "ENERGY FIRST-ONE" SH.P.K., do t'i lëshohet AUTORIZIMI për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues nga era, pas përmbushjes së kërkesave që dalin nga Nenet 14 dhe 15 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit dhe kërkesave tjera të legjislacionit tjetër të aplikueshëm lidhur me ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese.
- III. Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar nuk i jep të drejtë bartësit që të fillojë ndërtimin e stabilimentit të ri gjenerues para se t'i plotësojë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në pikën II. të këtij Vendimi.
- IV. Vendimi mbi njoftimin për autorizimin preliminar lëshohet për periudhë dy (2) vjeçare, brenda së cilës periudhë aplikuesi obligohet që ti plotësoi kërkesat sipas pikës II të diapozitivit të këtij Vendimi, dhe me shkrim të kërkojë lëshimin e Autorizimit për ndërtim të stabilimentit të ri gjenerues nga era.




Arsyetim


- ZRRE me datë 24.07.2014 nga shoqëria **“ENERGY FIRST-ONE” SH.P.K.**, ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga era, për projektin **“Wind Park–Bajgora”** me kapacitet të instaluar prej 56.1 MW, në lokacionin Selac, KK Mitrovica.
 - ZRRE, pas vlerësimit të aplikacionit, ka njoftuar shoqërinë **“ENERGY FIRST-ONE” SH.P.K.** se aplikacioni i tyre i tejkalon caqet e BRE-ve deri në vitin 2020, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2013 për caqet e BRE-ve, i nxjerrë nga MZHE.
 - ZRRE me datë 12.11.2014 nga shoqëria **“ENERGY FIRST-ONE” SH.P.K.**, ka pranuar kërkesën për rishqyrtim të aplikacionit për autorizim për projektin **“Wind Park–Bajgora”**, me të cilën aplikuesi modifikon/ndryshon kapacitetin e instaluar të gjeneratorit nga 56.10 MW në 34.25 MW, me arsyetim që aplikacioni të përfshihet brenda caqeve të BRE-ve deri në vitin 2020, ashtu siç është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2013 të MZHE-së.
 - ZRRE, ka analizuar kërkesën për rishqyrtim të aplikacionit për Autorizim të shoqërisë **“ENERGY FIRST-ONE” SH.P.K.**, duke konstatuar se kapaciteti i ndryshuar është brenda caqeve të BRE-ve deri në vitin 2020 të përcaktuar me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2013.
 - ZRRE, pas vlerësimit të kërkesave dhe dëshmive relevante të bashkangjitura aplikacionit, si dhe pranimit të dëshmive tjera plotësuese, të kërkuara nga ZRRE, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- V.** Ky Vendim është nxjerr në pajtim me Rregullin për Procedurën e Autorizimit që ka qenë në fuqi në momentin e kompletimit të aplikacionit për Autorizim të shoqërisë **“ENERGY FIRST-ONE” SH.P.K.**, sipas të cilës është bërë vlerësimi i aplikacionit nga Komisioni i ZRRE-së dhe Bordi i ZRRE-së.
- VI.** Kapaciteti i mbetur prej 21.85 MW që ka qenë pjesë e aplikacionit për Autorizim, do të trajtohet pas hyrjes në fuqi të Rregullës për Skemën Mbështetëse për BRE, ndërsa taksa për shqyrtim të aplikacionit për kapacitetin e mbetur, do të konsiderohet e kryer.
- VII.** Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- VIII.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.




Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE


Enver Halimi, kryesues


Merita Kostari, anëtare


Krenar Bujupi, anëtar